

Teklidi: kuptimi dhe realiteti i tij

Sejjid Muhammed Rizvi

Në Emër të Allahut, Gjithmëshiruesit, të Plotmëshirshmit

- ◆ Terma të përgjithshëm
- ◆ Ç'është teklidi?
- ◆ A është i arsyeshëm teklidi në epokën e përhapjes së arsimimit?
- ◆ Teklidi në Kur'an dhe Hadith
- ◆ Kushtet e nevojshme për t'u kualifikuar si *muxhtehid*
- ◆ Përse ka dallime mes muxhtehidëve në gjykimet e tyre ligjore?
- ◆ Shënime

Terma të përgjithshëm

Vaxhib – e detyrueshme, e domosdoshme, e obligueshme. Një veprim që duhet kryer patjetër, për kryerjen e të cilit muslimani/a shpërblehet dhe për moskryerjen e të cilit ai/ajo dënohet. Për shembull namazi i përditshëm, agjërimi i Ramazanit etj.

Vaxhib ihtijat – e detyrueshme për nga kujdesi. Kuptimi i tij është i ngjashëm me atë të vaxhibit, me dallimin se në çështjet për të cilat një muxhtehid thotë se janë të detyrueshme për nga kujdesi, muslimani ka mundësinë e të mosreferuarit atij në këtë pikë të veçantë dhe të ndjekë gjykimet e muxhtehidit të dytë më të aftë në këtë çështje.

Haram – e ndaluar, e palejuar. Është e domosdoshme të përmbahemi patjetër nga veprimet që janë haram. Nëse dikush kryen një veprim haram, ai do të dënohet. Për shembull, ngrënia e mishit të dërrit.

Sunnet, mustehab – e këshillueshme, e dëshirueshme. Veprimet, moskryerja e të cilave nuk dënohet, por kryerja e të cilave shpërblehet, për shembull thirrja për namaz (*ezani*).

Mekruh – e papëlqyeshme, e urryer, e pakëshillueshme. Veprime, kryerja e të cilave nuk ndëshkohet, por shmangia e të cilave shpërblehet, për shembull ngrënia në gjendje papastërtie rituale të shkaktuar nga marrëdhënia seksuale (*xhunub*).

Xha'iz, hallall, mubah – e lejuar, e ligjshme, e pandaluar. Veprimet ose gjërat që janë të lejuara dhe të ligjshme. Nuk ka shpërblim për kryerjen e tyre e as dënim për neglizhimin e tyre, për shembull të pirit çaj. *Mubah* përdoret përjashtimisht për gjërat e lejuara e jo për veprimet e lejuara.

1. Ç'është teklidi?

Teklid do të thotë fjalë për fjalë "me ndjekë (dikë)", "me imitue". Në terminologjinë ligjore islame ai do të thotë të ndjekësh një *muxhtehid* në ligjet dhe urdhëresat fetare të nxjerra prej tij. Muxhtehidi është një ekspert i jurisprudencës islame (*fikh*) dhe shpesh quhet edhe *fekih*. Për të parë se kur dhe ku u pranua ushtrimi i teklidit në botën shi'ite, është e nevojshme që ky koncept të shpjegohet më parë në njëfarë hollësie.

Natyra e njeriut dikton se ai mund të funksionojë siç duhet vetëm në shoqëri, dhe vetë shoqëria varet për ekzistencën e saj në ligje e rregulla. Islami mëson se që nga fillimi i ekzistencës Allahu ka dërguar një varg profetësh dhe lajmëtarësh me ligje hyjnore për udhëzimin e njeriut. I dërguari dhe profeti i fundit ishte Muhammed ibn 'Abdullahu (bekimet dhe paqja e Allahut qofshin mbi të dhe Familjen e tij), i cili solli të fundit dhe më të përsosurin e mesazheve fetare të Zotit, Islamit, i cili do t'i shërbejë si udhërrëfyes njerëzimit deri në fund të kohës.

Allahu është Krijuesi i njeriut dhe i gjithësisë, ndaj vetëm Ai mundet ose ka të drejtë të bëjë ligje për ne. Pejgamberët dhe të dërguarit janë mësues dhe shpallës të ligjeve e rregullave të Allahut; ata nuk mund të bëjnë ligje vetë. Mësimet e Islamit shi'i pohojnë se Imami është zëvendësi i Pejgamberit dhe vepron si ruajtës e interpretues i Islamit dhe i Ligjit të tij Hyjnor, Sheri'atit. Në periudhat e hershme të historisë islame, Profeti e udhëzoi bashkësinë muslimane (*ummeh*) në çdo hap që ajo hidhte e ishte i pranishëm për të zgjidhur të gjitha problemet e saj. Që nga koha e Imamit të parë, 'Ali ibn Ebi Talibit e deri në vdekjen e të njëmbëdhjetit, Imam Hasan el-'Askariut (paqe pastë mbi ta), shi'itët e merrnin udhërrëfimin drejtpërsëdrejti nga Imamët. Pastaj, gjatë periudhës së Fshehjes së Vogël (*el-ghajbetu's-sughra*) të Imamit të Dymbëdhjetë, ai caktoi vetë katër përfaqësues¹ që vepruan si ndërlihdës mes Imamit dhe shi'itëve të tij. Megjithatë, kur Imami i tanishëm (paqe pastë mbi të) u fut në Fshehjen e tij të Madhe (*el-ghajbetu'l-kubra*), më 329 H./941 e.s. me urdhrin e Allahut, shi'itët u obliguan të kryenin teklid në çështjet e tyre fetare.

2. A është i arsyeshëm *teklidi* në epokën e përhapjes së arsimit?

Nuk është gjithmonë e arsyeshme të ndiqen të tjerët e të kihet besim jokritik në opinionet e tyre. Mund të dallojmë katër forma të mundshme që mund të marrë imitimi:

- a) ai i një të padituri nga një i paditur,
- b) ai i një të dituri nga një më i ditur,
- c) ai i një të padituri nga një i ditur,
- d) ai i një të dituri nga një më pak i ditur.

Është mjaft e qartë se tri format e para të imitimit janë të paarsyeshme dhe nuk kanë asnjë dobi. Mirëpo, lloji i katërt është pa dyshim jo vetëm i arsyeshëm, por edhe i

domosdoshëm dhe çështje e logjikës së shëndoshë; në jetën e përditshme ne ndjekim dhe imitojmë të tjerët në shumëçka; neve na pëlqen të ndihemi se po marrim këshillën e ekspertëve në çështje që shtrihen përtej dijes sonë. Dikush që dëshiron të ndërtojë një shtëpi ia shpjegon idenë elementare të asaj që dëshiron ndërtuesit të tij dhe pastaj i bindet këshillës së tij se si duhet ta kryejë ndërtimin; invalidi ndjek trajtimin që i ka këshilluar mjeku; një person i përfshirë në një mospajtim ligjor konsulton një avokat kur paraqet çështjen e tij në gjyq. Shembujt janë të bollshëm; në shumicën e rasteve këshilla merret në mënyrë të vullnetshme, por nganjëherë qytetarit në një shtet mund t'i kërkohet me ligj që të kërkojë konsultë ligjore e të veprojë sipas saj, për shembull përpara se t'i lejohet të marrë një ilaç të rrezikshëm. Shembulli më i qartë është pa dyshim në rastin e një mospajtimi ligjor mes dy palësh, të cilave u kërkohet t'i paraqesin ankesat e tyre përpara një gjykatësi dhe t'i binden vendimit të tij, nëse nuk e zgjidhin dot miqësisht mospajtimin e tyre. Praktika e teklidit është një shembull i këtij lloji: personit që nuk është ekspert në jurisprudencë i kërkohet me ligj që të ndjekë urdhëresat e një eksperti, pra të një muxhtehidi. Dhe në këtë rast kërkesa është një detyrim që duhet zbatuar, sepse përbën një pjesë thelbësore të Ligjit Hyjnor.

Duhet vërejtur se teklidi ka të bëjë vetëm me sferën e Sheri'atit; nuk mund të ketë teklid në çështjet e besimit (*usul ed-din*). Muslimani duhet të besojë në parimet themelore të fesë së tij pasi të jetë bindur vetë për vërtetësinë e tyre, me anë të hetimit dhe thellimit. Kur'ani i qorton qartësisht ata që ndjekin të tjerët verbërisht në çështje të fesë:

{E kur u thuhet: 'Ejani tek ajo që ka zbritur Allahu, dhe (te) i Dërguari' ata thonë: 'Na mjafton ajo në të cilën i gjetëm paraardhësit tanë.' Si kështu?! Edhe pse paraardhësit e tyre s'kishin dije për asgjë e as nuk ishin të udhëzuar?} (5:104)

Ky qortim i fortë i idhujtarëve përsëritet gjetiu me fjalët:

{dhe kur u thuhet: 'Ndiqni atë që ka zbritur Allahu', ata përgjigjen, "Jo, por ne ndjekim ato në të cilat i kemi gjetur paraardhësit tanë"} (2:170, 31:21).

Kjo nuk do të thotë se njeriu duhet medoemos të besojë në kundërshtim me paraardhësit; ajo që Kur'ani thotë është se ata nuk duhen ndjekur verbërisht, pra pa ua shqyrtuar vlefshmërinë arsyeve pse duhen mbajtur ato bindje. Qëndrimi islam ndaj bindjeve themelore është se njeriu mund t'i marrë parasysh pikëpamjet dhe opinionet e të tjerëve, porse duhet të pranojë vetëm atë që është e arsyeshme të besohet:

{Ndaj, jepja (o Muhammed) sihariqet e mira shërbëtorëve të Mi që e dëgjojnë fjalën dhe ndjekin më të mirën presj saj. Ata janë që Allahu i ka udhëzuar e ata janë të mençurit} (39:17)

Si përmbledhje, mund të thuhet se e vetmja qasje e pranuar ndaj Islamit është duke i pranuar themelet e tij në një mënyrë, për të cilën njeriu është plotësisht i bindur për vlefshmërinë e tyre, dhe kjo mund të vijë vetëm nëse njeriu i heton ato me kujdes e vëmendje. Me t'i pranuar këto bindje, vijon për nga domosdoshmëria se njeriu duhet t'i

përmbahet Sheri'atit, ose duke ndjekur një *muxhtehid* nëpërmjet teklidit, ose duke iu përveshur arritjes së dijes dhe devotshmërisë në atë shkallë sa të bëhet *muxhtehid* vetë.

3. Teklidi në Kur'an e Hadith

Kur'ani i udhëzon muslimanët që të kërkojnë udhërrëfimin e njerëzve të ditur në çështje për të cilat u mungon njohuria:

{Pyeni njerëzit e përkujtimit (ehl ul-dhikr) nëse nuk dini.} (21:7)

Në ligjin islam është obligim që të studiohet gjithçka e nevojshme për zhvillimin shirtëror e material dhe mirëqenien e një bashkësie islame, por kjo është detyrë që njihet si *vaxhib kifa'i*.^{*} Në rastin në fjalë, për shembull, një shoqërie islame i nevojiten ekspertë në shkencat mjekësore, fizikë, kimi, inxhinjeri, arsim etj, dhe për sa kohë të ketë mungesë diturie në këto lëmi është obligim mbi bashkësinë në tërësi që ta arrijë atë, çka nënkupton se një grup muslimanësh duhet t'i përkushtohen patjetër hulumtimit që t'i jenë të dobishëm krejt bashkësisë. Po kështu, një shoqëri islame pa ekspertë në Sheri'at nuk mund ta mbajë veten si krejtësisht islame, prandaj është obligim që një grup personash nga kjo shoqëri t'i kushtohen studimit të shkencave fetare, në mënyrë që t'u sigurojnë udhërrëfim hyjnor të gjithë muslimanëve. Ky është edhe kuptimi i përmbajtur në ajetin kur'anor që pohon:

{Përse të mos dalë një pjesë nga çdo grup i tyre për të arritur të kuptuarit e thellë në fe dhe tërhequr vërejtjen njerëzve kur këta t'u kthehen, ashtu që të bëjnë kujdes?} (9:122)

Është e qartë se Imamët ishin të kënaqur nëse ndonjë prej ndjekësve të tyre u mësonte fenë ose jepte gjykime ligjore (*fetva*) të tjerëve. Ka një sërë rastesh të dokumentuara të shi'itëve që jetonin larg nga Medina, të cilët i kërkonin Imamit të kohës së tyre t'u caktonte dikë në trevat përkatëse për të gjykuar mes tyre në probleme fetare. Zekerijja ibn Adem el-Kummi dhe Junus ibn 'Abdur-Rahmani, për shembull ishin emëruar nga Imam 'Ali er-Rida për të zgjidhur mospajtimet në krahinat e tyre.² Në një hadith të famshëm, 'Umer ibn Handhaleh e pyeti Imam Sadikun mbi lejueshmërinë e të kërkuarit të një gjykimi nga një sundues jolegjitim ose gjykatësit e emëruar prej tij, nga dy shi'itë të përfshirë në një mospajtim mbi një borxh a trashëgimi. Imami u përgjigj se kjo ishte absolutisht e ndaluar. Kur Ibn Handhaleh e pyeti se ç' duhet të bënin atëherë, Imami i tha: "Ata duhet të kërkojnë njërin prej jush që transmeton thëniet tona, është kompetent për hallallin e haramin dhe i njej mirë udhëzimet tona e ta pranojnë si gjykues, sepse unë e caktoj atë mbi ju. Kundërshtuesi i gjykimit sipas udhëzimeve tona ka shpërfillur urdhrat e Allahut e na ka mohuar ne. Mosbindja ndaj nesh është mosbindje ndaj Allahut, e kjo përbën shirk"³

Në një hadith tjetër nga Imam Xha'fer es-Sadiku, kësaj here të përcjellë nga Imam Hasan el-'Askeriu (paqe pastë mbi ta), ai thotë: "... por nëse ka ndonjë *fekih* që i rri larg mëkatit,

mbron fenë, mposht dëshirat e egos dhe i bindet Zotit të vet njerëzit e kanë për detyrë ta ndjekin."⁴

Një hadith i tretë nga Imami i tanishëm, Muhammed el-Mehdiu (paqe pastë me të), i cili tha në një përgjigje për Is'hak ibn Ja'kubin: "Lidhur me rastet e reja që shfaqen, drejtojuni transmetuesve të thënieve tona, sepse ata janë prova (*huxhxheh*) ime mbi ju, siç jam unë prova e Allahut"⁵

Nga këto ajete kur'anore dhe hadithe të Imamëve mund të kuptojmë dy gjëra: 1) duhet të ketë gjithmonë një grup fekihësh në çdo shoqëri muslimane; 2) ata që nuk janë të kualifikuar si *fukaha'* ose muxhtehidë duhet të ndjekin një të tillë, dhe se shkelja e udhëzimit të tij në çështje fetare është baraz me politeizëm.

4. Kushtet e domosdoshme për kualifikimin si *muxhtehid*

Nga hadithi i dytë i cituar më lart mund të nxirret lehtë se të bërit ekspert në *fikh* dhe shkencat e tjera islame nuk mjafton në vetvete për t'u kualifikuar si *muxhtehid* të cilin mund ta ndjekin njerëzit. Përveç kësaj, Ligji islam parashtron se një *muxhtehid* duhet të jetë njeri i lirë, me lindje të ligjshme, në moshën e pjekurisë, i shëndoshë mendërisht, ndjekës i dymbëdhjetë Imamëve dhe '*adil* (që mund të përkthehet si 'i drejtë', por që përfshin cilësi të tjera morale e ligjore, si përzotshmërinë, vetpërmbytjen nga të gjitha ndalesat e Sheri'atit dhe përmbushjen e të gjitha obligimeve të tij).

Sa i përket çështjes se si duhet ta zbulojë një besimtar i zakonshëm se cili është muxhtehidi që duhet të ndjekë, ka tri mënyra të pranuar: 1) përmes dijes së tij personale nëse është vetë studiues feje; 2) përmes dëshmisë së dy personave '*adil* të ditur se dikush është *muxhtehid*; 3) përmes shkallës së popullaritetit që nuk lë asnjëfarë dyshimi për të qenit e dikujt *muxhtehid*.

Shumica e 'ulemave të sotëm mendojnë se është më e dëshirueshme të ndiqet një *muxhtehid el-a'lem*. Në kuptimin e përgjithshëm ky term do të thotë 'më i dituri', por në këtë kontekst specifik nënkupton fekihun që ka ekspertizën më të madhe në nxjerrjen e gjykimeve të Sheri'atit nga burimet e tij. Muxhtehidi më i ditur mund të njihet në cilëndo mënyrë në të cilën njihet edhe muxhtehidi.⁶ Mirëpo, nganjëherë është e vështirë për dijetarët shi'itë që të dallojnë se cili nga fekihët është më i dituri dhe, për pasojë, nga bashkësia mund të ndiqen më shumë se një *muxhtehid* në të njëjtën kohë, siç ndodh sot, por një shumësi e tillë nuk sjell ndonjë mospajtim praktik mbi çështjet ligjore brenda bashkësisë shi'ite.

5. Përse ka dallime mes *muxhtehidëve* në gjykimet e tyre ligjore?

Shumë njerëz habiten si ka mundësi që muxhtehidët dallojnë në opinionet e tyre fetare, apo fetvatë, ku themelet e ixhtihadit të tyre janë të njëjta. Së pari, duhet thënë se çfarëdolloj dallimi në *fetva* zor se është ndonjëherë në nivel kundërshtimi; është thuajse e

pamundur të gjendet një rast ku një *muxhtehid* thotë se një veprim është *vaxhib* e një tjetër thotë se është haram. Për shembull, rasti i lutjes të së premtës (*salatu'l-xhum'ah*). Të gjithë dijetarët shi'itë janë të mendimit se në kohën e pranisë së Imamit ky namaz është obligim të premtëve, sepse është Imami, ose përfaqësuesi i tij, ai që ka të drejtën t'i thërrasë njerëzit në namazin e xhumasë; por ata dallojnë në atë se cili është vendimi i duhur kur Imami është në Fshehje (*ghajbeh*). Megjithatë, ky dallim opiniononi nuk krijon asnjëfarë problemi praktik për bashkësinë. I ndjeri Ajetullah es-Sejjid Muhsin el-Hakim (vd. 1970) ishte i mendimit se namazi i xhumasë nuk është i detyrueshëm gjatë Fshehjes së Imamit, por nuk është gabim të kryhet nga dikush nëse ai supozon se kjo pritet prej tij, me kusht që ai të falë edhe namazin e drekës (*salatu'z-zuhr*). Ajetullah es-Sejjid Ebu'l-Kasim el-Khu'i thotë se "mund të zgjidhet ndërmjet kryerjes së namazit të drekës ose atij të xhumasë, por me t'u vendosur kjo e fundit me të gjitha kushtet e saj, është obligim për nga kujdesi (*vaxhib ihtijjat*) të merret pjesë në të." Ajetullah es-Sejjid Ruhullah el-Khumejni thotë se "mund të zgjidhet midis kryerjes së *salatu 'z-zuhr* ose *salatu 'l-xhum`ah*, por nëse zgjidhet kjo e fundit është e këshillueshme (*mustehab*) të kryhet edhe *salatu 'z-zuhr* si masë kujdesi."⁷ Megjithëse ekzistojnë këto dallime në opinionet e këtyre muxhtehidëve, nuk ka ndonjë përplasje, e cila për shembull do të pengonte ndjekësin (*mukal-lid*) e njerit prej tyre të merrte pjesë në namazin e xhumasë nëse ky vendoset.

Së dyti, duhet vërejtur se ekzistenca e dallimeve në opinionet shkencore s'duhet marrë si shenjë defekti qenësor në kërkimin e diturisë apo si arsye për braktisjen e plotë të tij; përkundrazi, ajo është shenjë se dituria lëviz në hapa progresivë drejt përsosjes. Dallimet në mendim shihen në të gjitha shkencat, jo vetëm në *fikh*. Për shembull, mund të ketë më shumë se një opinion për terapinë e një pacienti të caktuar dhe të gjitha opinionet mund të tejkalohen më vonë nëpërmjet zhvillimit të metodave të reja që merren me atë sëmundje. Kështu, këto vëzhgime mund të shihen si me vend jo vetëm për dallimet mes opinionëve të shkencëtarëve bashkëkohorë, por edhe dallimet historike, e të gjitha këto dallime duhen parë si shenja të dinamizmit brenda një shkence dhe etapave që duhen kaluar në rrugën e saj drejt përkryerjes.

Duhet mbajtur mend se muxhtehidi i formulon opinionet e tija pasi e çon hulumtimin dhe kërkimet në maksimumin e tij; kjo është e gjitha që pritet prej tij, sepse ai nuk është as i pagabueshëm e as njohës i të fshehtës (*'alim bi'l-ghajb*). Mukalidi urdhërohet të ndjekë opinionet e tij. Prandaj, edhe nëse fetvaja e muxhtehidit në të vërtetë nuk përputhet me urdhrin e vërtetë të Allahut, as ai nuk do të dënohet në Ditën e Gjykimit për nxjerrjen e fetvasë e as mukalidi, sepse të dy do të kenë bërë atë që u është urdhëruar dhe atë që ka qenë njerëzisht e mundur për t'u bërë.

Shënime:

1. Këta katër përfaqësues ishin: `Uthman ibn Sa`id el-`Amri, nga 260/875-6 deri 265/879; Muhammed ibn `Uthman el-`Amri, që na vdekja e të atit e deri në të tijën më 305/917; Husein ibn Rauh en-Naubakhti, nga atëherë deri më 326/937-8; dhe më në fund `Ali ibn Muhammed es-Samiri deri në vdekjen e tij më 329/940-1.
2. Shaykh Hurr al-`Amili, *Vesa'ilu 'sh-Shi`ah*, vol. 18, Tehran 1401 A.H., ff. 106-7.
3. Shaykh al-Kulejani, *Furu`u 'l-Kafi*, vol. 7, Tehran 1379, f. 412.
4. Shaykh at-Tabarsi, *al-Ihtixah*, vol. 2, Nexhef 1966, f. 263.
5. *po aty*, f. 283.
6. Shih Sejjid Muhammad Kazim et-Tabataba'i el-Jazdi, *al-`Urvatu'l-Vuthka'*, Tehran 1972 (me shënime nga merxhatë bashkëkohorë), f. 5.
7. Të shihen përpilimet e tyre të fetvave të njohura si *Teudihu 'l-masa'il* rregullat 733, 737 e 741.

* *Vaxhib kifa'i* = obligim mbi çdo anëtar të bashkësisë për sa kohë të mos plotësohet, por me t'u plotësuar nga një ose disa persona të saj nuk përbën më detyrim për ata që nuk e kanë kryer.